

# **NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA**

## **BASHKIA TIRANË** FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik "HE & SK 11" shpk  
Adresa: Gjirokaster Tepelene Lagjja "Mustafa Matohiti", Rruga "Mustafa Matohiti", banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe.

Procedura e prokurimit: Kolaudimi i punimeve për objektin Riaftësimi strukturor i ndërtesës Pallati Biba, Rr. 5 Maji, Loti VI.

Fondi limit: 40,000 (dyzet mijë) lekë pa tvsh.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF -30072-05-19-2022

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Tender i Kufizuar" me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Në mbështetje të Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Udhëzimit Nr.1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1, Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 52, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu V, seksioni 2 Neni 35, Neni 59.

Publikime të mëparshme: Nuk ka

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

1. Operatori ekonomik "A & E ENGINEERING" shpk NUIS K72113010E
2. Operatori ekonomik "HE & SK 11" shpk NUIS L19008502B
3. Operatori ekonomik "INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM" "IKN" shpk NUIS K71828007J
4. Bashkimi I Operatorëve ekonomik "TESLA VIZION" shpk & "IMES- D" shpk NUIS L31518001O; NUIS K82430006C

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "A & E ENGINEERING" shpk NUIS K72113010E  
Oferta ekonomike = 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “HE & SK 11” shpk NUIS L19008502B  
Oferta ekonomike = 34,900 (tridhjetë e katër mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH

*Nuk ka Operatorë ekonomikë të s’kualifikuar*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “HE & SK 11” shpk se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15% të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktin Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 12/05/2023.

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.